Allahu do t'i tubojë të gjithë njerëzit, të parët dhe të fundit, në një vend, saqë zëri i thirrësit i arrin çdonjërit dhe syri mund t'i përfshijë të gjithë. Dielli do t'u afrohet shumë afër dhe njerëzit do të pushtohen nga ankthi dhe brengat, aq sa s'mund të durojnë dhe s'mund ta bartin

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Të Dërguarit të Allahut i sollën pak mish dhe i ofruan një shpatull, të cilën ai e pëlqente. Ai e kafshoi një herë, pastaj tha: “Unë do të jem zotëria i njerëzve Ditën e Kiametit. Dhe, vallë, e dini përse?! Allahu do t'i tubojë të gjithë njerëzit, të parët dhe të fundit, në një vend, saqë zëri i thirrësit i arrin çdonjërit dhe syri mund t'i përfshijë të gjithë. Dielli do t'u afrohet shumë afër dhe njerëzit do të pushtohen nga ankthi dhe brengat, aq sa s'mund të durojnë dhe s'mund ta bartin. Kështu, do t'i thonë njëri-tjetrit: “A nuk po e shihni në çfarë gjendjeje keni ardhur?” Pse nuk gjeni dikë të ndërmjetësojë te Zoti juaj? Disa thonë: “Shkoni tek Ademi. Shkojnë tek ai dhe i thonë: “Ti je babai i njerëzimit, Allahu të ka krijuar me Dorën e Vet dhe të ka fryrë shpirt me Frymën e Tij, si dhe melekët i ka urdhëruar të bien në sexhde për ty, andaj ndërmjetëso te Zoti yt për ne! A nuk sheh në çfarë gjendjeje kemi ardhur?” Ai u thotë: “Sot, Zoti im është zemëruar shumë, si kurrë më parë, dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj. Ai ma pati ndaluar pemën, e unë i bëra mëkat. Vetja ime! Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër! Shkoni te Nuhu!” Kur shkojnë te Nuhu, i thonë: “O Nuh, ti je i dërguari i parë te banorët e Tokës dhe Allahu të ka quajtur rob falënderues, ndërmjetëso te Zoti yt për ne! A nuk sheh çfarë na ka gjetur?” Ai u thotë: “Sot Zoti im i Lartësuar është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj. Lutjen time të pakthyeshme e kam shfrytëzuar për popullin tim. Vetja ime! Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër! Shkoni tek Ibrahimi!” Kështu, shkojnë tek Ibrahimi dhe i thonë: “O Ibrahim, ti je i dërguari dhe miku i Allahut nga banorët e Tokës, ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk sheh në çfarë gjendjeje kemi ardhur?” Ai ua kthen: “Sot Zoti im është zemëruar si kurrë më parë, dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj. Unë pata gënjyer tri herë. Vetja ime! Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër! Shkoni te Musai!” Kur shkojnë te Musai, i thonë: “O Musa, ti je i dërguari i Allahut dhe Ai të ka dalluar nga njerëzit e tjerë me shpallje dhe të ka folur drejtpërdrejt. Ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk sheh çfarë na ka gjetur?” Ai u thotë: “Sot Zoti im është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj. Ndërkohë, unë pata vrarë një njeri që nuk më lejohej. Vetja ime! Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër! Shkoni tek Isai!” Me të shkuar tek Isai, i thonë: “Ti je i dërguari i Allahut dhe fjala e Tij që ia ka vendosur Merjemes, si dhe frymë prej Tij. U pate folur njerëzve qysh në djep, duke qenë foshnjë. Ndërmjetëso për ne! A nuk sheh çfarë na ka gjetur?”

Isai u thotë: “Sot Zoti im është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kështu.” - Pa përmendur ndonjë mëkat, vazhdon: - “Vetja ime! Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër! Shkoni te Muhamedi !” Kështu, kur shkojnë te Muhamedi , i thonë: “O Muhamed, ti je i Dërguari i Allahut dhe vula e pejgamberëve. Allahu t'i ka falur mëkatet e kaluara dhe të ardhshmet. Ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk sheh në çfarë gjendjeje kemi ardhur?” Prandaj, unë shkoj nën Arsh dhe bie në sexhde për Zotin tim të Lartmadhëruar. Allahu më frymëzon me falënderime dhe lëvdata ndaj Tij, që askujt më parë nuk ia ka shfaqur, pastaj Ai thotë: “O Muhamed, ngrije kokën dhe kërko, që të të jepet, ndërmjetëso, se do të të pranohet ndërmjetësimi!” Unë e ngre kokën dhe them: “Umeti im, o Zot! Umeti im, o Zot!” Më thuhet: “O Muhamed, gjithë pjesëtarët e umetit tënd, që nuk do të merren në llogari, futi nëpërmjet portës së djathtë të Xhenetit, njëherazi ata janë pjesëmarrës edhe nëpër portat e tjera me të tjerët!” Pastaj tha: “Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, se mes dy skajeve të portave të Xhenetit ka hapësirë sa prej Mekës deri në Himjer, - ose ka thënë: sa prej Mekës deri në Busra.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ishte me shokët e tij në një ftesë për ushqim. Iu ofrua shpatulla e deles, e cili ishte pjesa më e dashur e mishit për të. Ai e kafshoi lehtë me majat e dhëmbëve të tij, pastaj filloi t’ua tregojë këtë hadith dhe tha: "Unë do të jem zotëria i njerëzve Ditën e Kiametit", - kjo është që t'ua tregosh të tjerëve begatitë e Allahut të Lartësuar që do të t'i dhurojë. Pastaj do të thotë: "A e dini për çfarë bëhet fjalë? Kjo është se njerëzit do të mblidhen në Ditën e Kiametit në një tokë të gjerë, të sheshtë dhe të zgjatur në mënyrë të barabartë. Ata që janë aty do ta dëgjojnë zërin e thirrësit, i cili i arrin çdonjërit dhe shikimi mund t'i përfshijë të gjithë; asgjë prej tyre nuk do të fshihet, sepse toka do të jetë e rrafshët dhe askush nuk do të ketë ku të fshihet nga shikuesit. Shikimi do t’i përfshijë të gjithë. Pra, nëse njeriu flet, do ta dëgjojë edhe i fundit, dhe shikimi do t’i përfshijë të gjithë. Dielli do t’u afrohet krijesave në një distancë sa një milje, e njerëzit do të pushtohen nga ankthi dhe brengat, aq sa s'mund të durojnë dhe s'mund ta bartin, e atëherë do të kërkojnë shpëtim përmes ndërmjetësimit. Atëherë Allahu i Lartmadhëruar do t’i frymëzojë besimtarët që të shkojnë te Ademi, babai i njerëzimit. Ata do të shkojnë tek ai dhe do t’ia përmendin virtytet e tij, me shpresë që ai të ndërmjetësojë për ta tek Allahu i Lartmadhëruar. Do t’i thonë: “Ti je Ademi, babai i njerëzimit, Allahu të ka krijuar me Dorën e Vet, i ka urdhëruar melekët të bien në sexhde për ty, t'i mësoi emrat e çdo gjëje dhe të ka fryrë shpirt me Frymën e Tij." Por ai do të kërkojë ndjesë dhe do të thotë: “Sot Zoti im është zemëruar shumë, si kurrë më parë, dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj." E pastaj e përmend mëkatin e tij, se Allahu i Lartmadhëruar e ndaloi të hajë nga pema, por ai hëngri prej saj. Prandaj thotë: "Vetja ime është ajo që ka nevojë për ndërmjetësim. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Nuhu!” Atëherë ata do të shkojnë te Nuhu dhe do t’i thonë: “Ti je i dërguari i parë që Allahu e dërgoi tek banorët e tokës, dhe Allahu të quajti rob falënderues.” Por ai do të kërkojë ndjesë dhe do të thotë: “Sot Allahu i Lartmadhëruar është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj." Ai do të tregojë se e kishte pasur një lutje të pakthyeshme që e ka bërë kundër popullit vet. Prandaj thotë: "Vetja ime është ajo që ka nevojë për ndërmjetësim. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Ibrahimi.” Atëherë njerëzit do të shkojnë te Ibrahimi dhe do t’i thonë: “Ti je miku i Allahut nga banorët e Tokës, ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk sheh në çfarë gjendjeje kemi ardhur?” Ai do t’u thotë: “Sot Zoti im është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë

nuk do të zemërohet kësisoj. Unë pata gënjyer tri herë.” E këto tria janë kur ka thënë: "Unë jam i sëmurë", kur ka thënë, "Këtë e ka bërë më i madhi prej tyre", dhe kur i ka thënë gruas së tij Sarës: "Thuaji atij (tirani) se unë jam vëllai yt", që të shpëtojë nga e keqja e tij. E vërteta është se këto tri fjalë ishin vetëm nga mënyrat e të folurit me nënkuptim, tërthorazi, mirëpo, meqë forma e tyre i ngjante gënjeshtrës, ai u frikësua prej tyre dhe e pa veten të vogël për të ndërmjetësuar (në Ditën e Gjykimit), sepse, sa më shumë që robi e njeh Allahun dhe sa më afër të jetë në pozitë tek Ai, aq më shumë i frikësohet. Prandaj thotë: "Vetja ime është ajo që ka nevojë për ndërmjetësim. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Musai!” Pastaj do të shkojnë te Musai (alejhis selam!) dhe do t’i thonë: "O Musa, ti je i dërguari i Allahut dhe Ai të ka dalluar nga njerëzit e tjerë me shpallje dhe të ka folur drejtpërdrejt. Ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk sheh çfarë na ka gjetur?” Ai u thotë: “Sot Zoti im është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kësisoj. Ndërkohë, unë pata vrarë një njeri që nuk më lejohej." Prandaj thotë: "Vetja ime është ajo që ka nevojë për ndërmjetësim. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Isai, i biri i Merjemes!” Pastaj do të shkojnë te Isai dhe do t’i thonë: “O Isa! Ti je i dërguari i Allahut dhe fjala e Tij që ia ka vendosur Merjemes, si dhe frymë prej Tij. U pate folur njerëzve qysh në djep, duke qenë foshnjë. Ndërmjetëso për ne! A nuk sheh çfarë na ka gjetur?” Isai u thotë: “Sot Zoti im është zemëruar si kurrë më parë dhe asnjëherë nuk do të zemërohet kështu.” - Pa përmendur ndonjë mëkat, vazhdon: "Vetja ime është ajo që ka nevojë për ndërmjetësim. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Muhamedi!” Pastaj do të shkojnë te Muhamedi dhe do t’i thonë: "O Muhamed, ti je i Dërguari i Allahut dhe vula e pejgamberëve. Allahu t'i ka falur mëkatet e kaluara dhe të ardhshmet. Ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk sheh në çfarë gjendjeje kemi ardhur?” Prandaj, unë shkoj nën Arsh dhe bie në sexhde për Zotin tim të Lartmadhëruar. Allahu më frymëzon me falënderime dhe lëvdata ndaj Tij, që askujt më parë nuk ia ka shfaqur, pastaj Ai thotë: "O Muhamed, ngrije kokën dhe kërko, që të të jepet, ndërmjetëso, se do të të pranohet ndërmjetësimi!” Unë e ngre kokën dhe them: “Umeti im, o Zot! Umeti im, o Zot!” Kështu ndërmjetësimi i tij do të pranohet. Atij do t'i thuhet: "O Muhamed, gjithë pjesëtarët e umetit tënd, që nuk do të merren në llogari, futi nëpërmjet portës së djathtë të Xhenetit, njëherazi ata janë pjesëmarrës edhe nëpër portat e tjera me të tjerët!" Pastaj do të thotë: "Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Gjerësia midis dy anëve të portës së Xhenetit është sa largësia midis Mekës dhe Sanasë në Jemen, ose sa largësia midis Mekës dhe Busrasë në Sham; qytet në rajonin e Huranit."

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/8345